



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:184426
Datë: 02.10.2023
Numri i dokumentit: 04744395

PPP.nr.463/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A, me seli në Prishtinë, Rr.“28 Nëntori” nr.181, ndaj debitorit O.K nga P, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson F.M, avokat në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore për përmbushjen e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.222/23 të datës 28.07.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 02.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit O.K nga Prishtina, ashtu që Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.222/23 i datës 28.07.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj në Prishtinë, për periudhën kohore nga data 31.10.2020 e deri me datë 31.12.2021 në shumë prej 412.65 €, SHFUQIZOHET.

II. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit O.K nga Prishtina, sa i përket pjesës së borxhit për periudhën kohore nga data 31.01.2022 e deri me datë 30.04.2022 në shumën prej 177.07 €, ndërsa sa i përket kësaj pjese Urdhri Përmbartimor P.nr.222/23 i datës 28.07.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj në Prishtinë, mbetet në fuqi.

III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 177.07 €.

IV. Në rast se debitori dështon të paguajë shumën e lartëcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në

bazë të dokumentit të besueshëm - kartelës së kontabilitetit me shifrën ID nr.005205, të dt.28.07.2023, për shërbimet e ngruhjes për periudhën kohore: 31.10.2020 deri më 30.04.2022, në shumë prej 589.72 €, me të cilin ka kërkuar që të obligohet debitori që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit borxhin, me kamatë prej 8 % deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përbarimit sipas tarifës së përbaruesve privat.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor, debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim. Në prapësimin e ushtruar i njëjti ka theksuar se e kundërshton në tërësi urdhrin P.nr.222/23 të datës 28.07.2023, duke pretenduar se dokumenti në bazë të të cilit është lejuar përbarimi nuk e ka cilësinë e dokumentit të ekzekutueshëm sipas nenit 24 par.1 të LPP-së. Po ashtu, pretendon se kemi të bëjmë me borxh të pa argumentuar dhe inekzistent, i cili në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së është borxh i parashkruar. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që Urdhëri Përbarimor të anulohet dhe propozimi për përbarim i kreditorit të hedhet poshtë si i pa bazuar.

Në përgjigje në prapësim, kreditori ka deklaruar se prapësimi i debitorit është ushtruar vetëm sa për të prolonguar procedurën sepse borxhi është periodik, duke shtuar se nuk është parashkruar e drejta për të kërkuar borxhin për vitin 2022, sepse në bazë të nenin 360 par.2, kreditori mund të kërkojë borxhin deri me 31 dhjetor të vitit kalendarik, e në rastin konkret borxhi i vitit 2022, mund të kërkohej deri me 31.12.2023. Tutje theksohet se periudha prej dt.31.01.2022 deri me dt.30.04.2022, për borxhin në shumë prej 177.07 Euro nuk është parashkruar. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që urdhri përbarimor të mbetet në fuqi dhe prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës erdhi në përfundim se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesërishtë të kërkesës së kreditorit, rrjedhimisht prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, për arsytet si në vijim:

Dispozita nga neni 29 par.1 e LPP-së, ka përcaktuar llojet e dokumenteve të besueshme, në bazë të të cilave mund të caktohet përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla. Në nënpar 1.2 të këtij neni përcaktohet: *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Në anën tjetër, paragrafi 3 i të njëjtës dispozitë përcakton: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.”*

Në rastin konkret, propozimi për përbarim është lejuar në bazë të ekstraktit – kartelës së kontabilitetit nën shifrën me ID nr.005205, të dt.28.07.2023, e për të cilin dokument Gjykata vlerëson se paraqet dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 par.1 pika.1.2 lidhur me par.3 të LPP-së.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës në kuptim të dispozitës së nenit 341 par.3 të LMD-së dhe erdhi në përfundim se në raport me borxhin për periudhën kohore nga data 31.10.2020 e deri me dt.31.12.2021, kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës në kuptim të dispozitës nga neni 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077. Në anën tjetër, sa i përket

periudhës kohore nga data 31.01.2022 e deri me dt.30.04.2022, nuk ka ardhur në shprehje parashkrimi i kërkesës së kreditorit, për faktin se nuk ka kaluar periudha kohore e paraparë në nenin 360 par.1 nënpar.1 të LMD i cili parasheh se: *“kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti janë: “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake dhe par.2 “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*. Gjykata vlerëson se borxhi i parashkruar konsiston në shumën prej 412.65 €, dhe atë për periudhën kohore nga dt.31.10.2020 e deri me dt.31.12.2021, pasi që propozimi për përmbarim të Përmbaruesi Privat është paraqitur me datën 28.07.2023. Në anën tjetër, sa i përket faturimit të borxhit nga periudha 31.01.2022 e deri me 30.04.2022, nga kartela e kontabilitetit që përmban faturimin muaj për muaj, Gjykata vërtetoi se borxhi i mbetur i debitorit në raport me kreditorin arrin shumën prej 177.07 €. Kreditori me propozimin e datës 28.07.2023, ka kërkuar borxhin për periudhën 31.10.2020 deri me 30.04.2022, konkretisht për një periudhë të kufizuar, andaj bazuar në faktet e tilla, Gjykata konkludoi se debitori në këtë periudhë nuk ka bërë pagesa për shfrytëzimin e shërbimeve të ngrohjes, rrjedhimisht nuk kemi ndërprerje të parashkrimit, konform dispozitave të nenit 368 par.2 të LMD-së.

Bazuar në këto fakte, Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, në pajtim me nenin 73 par.2 dhe 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin lidhur me pjesën e kërkesës e cila është parashkruar, në shumën prej 412.65 €, ndërsa e ka refuzuar prapësimin pjesërisht për pjesën e mbetur të borxhit, në shumën prej 177.07 €.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi debitorin që në rast të parashkrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 177.07 €, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e paralajmëroi debitorin se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.463/23 datë 02.10.2023

Gj y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtut. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.